



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1562 Prot.

Durrës, më 5.10.2023

VENDIM
Nr. 58, datë 5.10.2023

PËR

"MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË KUOTAVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR NË "ARSIM PARASHKOLLOR" DHE PROGRAM 2-VJEÇAR ME KARAKTER PROFESIONAL "EDUKATOR PËR MOSHËN 0-3 VJEÇ", NË FAKULTETIN E EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës".

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Udhëzimin nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, në Urdhërin e përbashkët RASH dhe QSHA nr. 10 datë 10.07.2023 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2023-2024", në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu", në shkresën e Fakultetit të Edukimit, Senati Akademik;

VENDOSI:

1. Miratimin e rishpërndarjes së kuotave në ciklin e parë të studimeve, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", për kuotat e mbetura për shkak të mos aplikimit në kategori të ndryshme, si më poshtë:
 - Programi i studimit Bachelor "Arsim Parashkollor": 9 kuota të mbetura (5 kuota nga "program i dytë studimi", 2 kuota nga "transferim studimesh", 1 kuotë nga Statusi i "Jetimit", 1 kuotë nga "persona me aftësi të kufizuara"), të rishpërndahen, në "Shqiptarë brenda vendit";

- Programi 2-vjeçar me karakter profesional “Edukator për moshën 0-3 vjeç”: 12 kuota të mbetura (1 kuotë nga Statusi i “Jetimit”, 3 kuota nga “pakica Rom dhe Egjiptiane”, 1 kuotë nga “studentë nga Kosova”, 7 kuota nga program I studimit I ciklit të parë, Bachelor në “Gjuhë Gjermane dhe Angleze”), të rishpërndahen në “Shqiptarë brenda vendit”;

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- ✓ Zv. Rektorët.
- ✓ Administratori i Universitetit.
- ✓ Drejtuesit e Njesisë Kryesore.
- ✓ Drejtuesit e Njesisë Bazë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksena SOTIROFSKI

